



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2022:112968

Datë: 12.07.2022

Numri i dokumentit: 03219201

P.nr.99/2022

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, gjyqtari Sadri Krasniqi, me sekretaren juridike Tevide Thaqi, në lëndën penale kundër të akuzuarve: H. F. dhe V. F. që të dy nga ....., për shkak se, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Kontrabandim me mallra nga neni 311, parag. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuarin H. F. e mbron me autorizim av. S. S., duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani, PP.II.nr.856/2022, të datës 13.06.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar në prani të Prokurores së Shtetit Leonora Kadriu, të akuzuarve H. F. dhe V.F.dhe mbrojtësin av. S. S., më datën 08.07.2022 shpalli dhe publikisht komunikoi, ndërsa më datën 12.07.2022 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

Të akuzuarit:

**1.H. F.**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati A. dhe e ëma R., mbiemri i vajzërisë Sh., i lindur më ....., në ....., me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i një fëmije, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, në bazë të evidencës që disponon gjykata i akuzuari nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

**2. V. F.**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati H. dhe e ëma N., mbiemri i vajzërisë K., i lindur më ....., në ....., me nr. personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punësuar, i gjendjes jo të mirë ekonomike, në bazë të evidencës që disponon gjykata i akuzuari ka qenë i dënuar për vepra tjera penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

**Janë fajtor**

**Sepse:**

Më datë 31 Maj 2022, rreth orës 19:15 min, në fshatin ....., të pandehurit H. F. dhe V. F., në bashkëkryerje dhe me dashje, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material për vete apo për tjetër kënd, kanë kaluar vijën kufitare dhe shmangur kontrollin doganor, duke ardhur nga Serbia përmes rrugëve malore në drejtim të fshatrave ....., ashtu që gjatë një kontrole nga zyrtarët policor që i është bërë kamionit transportues të tipit “.....”, ngjyrë ....., pa targa, të cilën po e drejtonte i pandehuri H. F., kanë qenë të ngarkuar 21 trungje, drunjë industrial, me gjatësi 5 m, dhe me vëllim të përgjithshëm prej 11.90 m<sup>3</sup>, në vlerë prej 297.00 euro, pa asnjë dokument përcjellës për prejardhjen e mallit, në këtë mënyrë të pandehurit me veprimet e tyre, përmes rrugëve ilegale kanë bërë bartjen e mallit duke i shkaktuar buxhetit të Republikës së Kosovës dëm në shumë prej 88.50 euro.

- me çka në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Kontrabandim me mallra nga neni 311 parag. 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, lidhur me nenin 248, 365 dhe 453 të KPPRK-së, të akuzuarit H. F. dhe V. F. i,

## G J Y K O N

Me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej **nga 500 €**, secili i akuzuar, të cilën shumë kanë për ta arkëtuar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën të njëjtit dënime me gjobë do t’iu zëvendësohen me dënime burgu ashtu që për çdo 20 €, do t’iu llogaritet nga një ditë burgu,

Në dënimet e shqiptuara me gjobë të akuzuarve i`u llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak, edhe atë prej 31.05.2022 e deri më 15.06.2022.

Në kuptim të nenit 115 parag. 2, i KPPRK-së, lidhur me nenin 311, paragrafi 6, të KPRK-së, të akuzuarve H. dhe V. F., iu **Konfiskohet** masa drunore prej 11.90 m<sup>3</sup>, dru industrial, të cilat iu janë sekuestruar përkohësisht sipas Urdhëresës për sekuestrimin e përkohshëm PN.nr.42/2022, të datës 06.06.2022, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjta dru të shiten konform dispozitave të Ligjit për procedurën përmbaremore, vlera e të cilit mall bie në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pala e dëmtuar Dogana e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

**Urdhërohet** Drejtoria Rajonale Kufitare-Lindje Kaçanik-SPMK-Muçiverc, që menjëherë, pas pranimit të këtij aktgjykimi, të akuzuarit H. F. nga ....., t’ia kthej kamionin e

llojit “..... ” me kran, çelësat dhe Librezën e qarkullimit ....., të sekuestruar përkohësisht sipas Vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të mallit 2022-YED-044, të datës 31.05.2022.

Detyrohen të akuzuarit, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu të akuzuarit obligohen që në kuptim të nenit 39, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguajnë shumën prej nga 30 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.856/2022, të parashtruar më 14.06.2022, ka kërkuar që ndaj të akuzuarve: H.F.dhe V. F. që të dy nga ....., të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak se, në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Kontrabandim me mallra nga neni 311 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se aktakuza është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datë 06.07.2022, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës, prokurorja e shtetit bën rikualifikimin e veprës penale, edhe atë nga neni 311, paragrafi 1, në nenin 311, paragrafin 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Ndërsa të akuzuari H. F. dhe V. F., deklarojnë se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen, njëherit theksojnë se e pranojnë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga të akuzuarit.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se të akuzuarit H.F. dhe V. F., në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale: Kontrabandim me mallra nga neni 311 parag. 2, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, për të cilën veprën penale, gjykata të akuzuarit i shpalli fajtorë, ngase veprimet e të njëjtëve i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën janë edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Leonora Kadriu në fjalën përfundimtare deklaron se gjatë shqyrtimit fillestar të akuzuarit H. F. dhe V. F. e pranuan fajësinë për veprën penale e cila i u vihet në barrë, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu si që është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike deklaron se mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban, andaj kërkon nga gjykata që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të njëjtit t'i dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marr parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale. Njëherit i propozoj gjykatës që në pajtim me nenin 311, paragrafi 6 dhe 7 të KPRK-së, të akuzuarve të i konfiskohet kamioni i markës “.....” dhe 11.90 m<sup>3</sup> dru industrial.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.F., av. S. S. në fjalën përfundimtare deklaron se, pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë, dhe i njëjti më parë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është i pa punë, prind i një fëmije të mitur, kërkon nga gjykata që brenda mundësive t'i shqiptojë një dënim sa më të ulët të paraparë me ligj, e po ashtu e kundërshton propozimin e prokurores së shtetit për konfiskimin e automjetit transportues të llojit “Mercedes”, andaj kërkon nga gjykata që i njëjti automjet t'i kthehet të akuzuarit H.F..

I akuzuari H. F. në fjalën përfundimtare deklaroi se, e përkrahi në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, e pranon fajësinë dhe veprën penale për të cilën ngarkohet nga prokuroria e shtetit, është penduar dhe premtton se më nuk do të kryej vepra të tilla po të tjera penale, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, andaj kërkon nga gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh faktet e cekura më lartë, në

mënyrë që mundësisht gjykata ta liroj nga dënimi apo t'i shqiptoi një dënim sa ma të butë konform ligjit, si dhe mundësisht t'a kthej automjetin transportues të sekuestruar.

I akuzuari V.F. në fjalën përfundimtare deklaroi se, e pranon fajësinë dhe veprën penale për të cilën ngarkohet nga prokurorja e shtetit, është penduar dhe premtun se më nuk do të kryej vepra të tilla po të tjera penale, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin, si prind i dy fëmijëve të mitur, jetoj në kushte të vështira ekonomike, andaj kërkon nga gjykata që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh faktet e cekura më lartë, në mënyrë që mundësisht ta liroj nga dënimi apo t'i shqiptoi një dënim sa ma të butë konform ligjit.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarve për këtë veprë penale të kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritort të dënimit ligjor. Për këtë rast si rrethana lehtësuese pati parasysh pranimin e fajësisë nga të akuzuarit, gjendjen e tyre jo të mirë ekonomike në të cilën jetojnë, se janë penduar thellë për veprën penale të kryer, se përherë të parë ka rënë ndesh me ligjin, se ndaj tyre nuk zhvillohet procedurë tjetër penale. Po ashtu gjykata pati parasysh edhe vlerën e vogël të shmangies doganor, prej 88.50 €. Ndërsa gjykata, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese për të akuzuarit. Andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, iu ka shqiptuar dënimet me gjobë si në dispozitiv të aktgjykimit. Gjkata, po ashtu vlerësoi se edhe me këto dënime me gjobë, do të arrihet qëllimi i dënimit, si dhe do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarve që në të ardhmen të mos kryejnë veprë penale të këtillë apo të ngjashme.

Në pajtim me nenin 365, paragrafin 1, pika 1,5 të KPRK-së, në dënimet e shqiptuara me gjobë të akuzuarve i'u llogaritet edhe koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak, edhe atë prej 31.05.2022 e deri më 15.06.2022.

Në kuptim të nenit 115 parag. 2 të KPRK-së, lidhur me nenin 311, paragrafi 6, të KPRK-së, të akuzuarve H. dhe V. F., iu Konfiskohen, 11.90 m<sup>3</sup> dru industrial, të cilat janë sekuestruar përkohësisht sipas Urdhresës për sekuestrimin e përkohshëm PN.nr.42/2022, të datës 06.06.2022, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjta dru të shiten konform dispozitave të Ligjit për procedurën përmbartimore, vlera e të cilit mall bie në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Pala e dëmtuar Dogana e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Gjykata duke pasur parasysh vlerën e vogël të mallit të kontrabanduar- në shumën prej 297.00 €, pastaj vlerën e shmangie doganore vetëm prej 88.50 €, e posaçërisht faktin se të akuzuarit për herë të parë kanë rënë ndesh me ligjin, nuk e aprovoj propozimin e prokurores së shtetit për konfiskimin e automjetit transportues me të cilin është kryer vepra penale. Ndërsa **Urdhëron** Drejtoria Rajonale Kufitare-Lindje Kaçanik-SPMK-Muçiverc, që menjëherë, pas pranimit të këtij aktgjykimi, të akuzuarit H. F. nga ..... t'ia kthej automjetin transportues, kamionin e llojit ".....", me kran, çelësat dhe Librezën e qarkullimit ....., të sekuestruar përkohësisht sipas Vërtetimit mbi marrjen e përkohshme të mallit 2022-YED-044, të datës 31.05.2022.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarve, e në pajtim me dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450, paragrafi 2, pika 2.6 e KPPRK-së, gjykata i obligon të akuzuarit që të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 20 € (Njëzetë euro), si dhe nga 30 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 368 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:112968, 12.07.2022**

**G j y q t a r i**

**Sadri Krasniqi,d.v.**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.